

UP-ja do ta hapë vitin e ri akademik me dy masterë programe të reja

Studime sipas standardeve evropiane

Prishtinë, 29 maj - Universiteti i Prishtinës (UP) dhe organizata austriake në mbështetje të arsimit "Wus Austria" të premtën e kanë nënshkruar kontratën për jetësimin e marrëveshjes për hapjen e dy masterëve sipas standardeve evropiane në universitetin publik. Menaxhimi shëndetësor master programi, që do të zhvillohet në Fakultetin e Mjekësisë dhe Mekatronika masteri i dytë, që do të hapet me bashkëpunimin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe

Kompjuterike dhe atij të Inxhinierisë Mekanike do të ofrohen për studentët nga tetori i këtij viti. Udhëheqësi i "Wus Austria", But Dedaj, tha se në këto studime mund të pranohen për secilin drejtim vetëm nga 25 studentë. Dedaj tha se programet do të realizohen në bashkëpunim me Universitetin e Vjenës dhe atë të Gracit. Ndërkaq, rektori i UP-së, Enver Hasani, tha se ky universitet do të angazhohet që të punojë maksimalisht në implementimin e këtij projekti. Ai e ka falën-

deruar Qeverinë austriake për mbështetjen që i ka dhënë UP-së në realizimin e synimeve drejt Procesit të Bolonjës.

Këto masterë programe do të zhvillohen në gjuhën angleze dhe UP-ja do ta shënojë hapin e parë që t'i lëshojë diplomat e para të përbashkëta me universitetet austriake. Programi për Zhvillim të Studimeve Master përkrah fakultetet e interesuara të UP-së në zhvillimin e programeve master në bazë të nevojave të tregut. (a. kadriu)

"LAJMI", 30/05/2009